



AKTI I THEMELIMIT
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“MELDI” SH.P.K.

Themeluesit që firmosin si më poshtë:

Mehmet Shaholli i biri Halimit dhe i Dudijes me dt.lindje 24.03.1963,lindur e banues në Cipan të rrethit Devoll me numër pasaporte 1687869 dhe Elina Shaholli e bija e Xhevairit dhe e Skënderies me dt.lindje 12.10.1964 me banim ne Cipan të rrethit Devoll me nr.pasaporte 11 34151.

Sot më daten 08.03.2002. bazuar në vullnetin e tyre të lirë dhe në perputhje me ligjin Nr.7638 datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregëtare”,vendosën të themelojnë Shoqërinë tregëtare me përgjegjesi të kufizuar “Meldi”sh.p.k,në bazë të kushteve që vijojnë:

Kreu I

OBJEKTI,EMERTIMI,SELIA,RREGJIMI JURIDIK

Neni 1 Objekti i Veprimtarisë do të jetë:

1- Tregëtim me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshme ushqimore,bujqësore,farera,fidanë, pesticide,materiale ndertimi,makineri e pajisje dhe veprimtari të ushqimit social,bar-restorant.

Neni 2 Emertimi dhe Selia e Shoqërisë.

1- Asamblea e Ortakeve vendosi që Shoqërine ta emertojë:”Meldi”SH.P.K.

2- Selia e Shoqërise do të jetë në qytetin e Bilishtit të rrethit Devoll.

3- Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare,filiale,zyra perfaqësimi e agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

Neni 3 Regjimi juridik

1- Shoqëria është shoqëri me përgjegjesi të kufizuar. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të aktit të Themelimit,Statutit,si dhe legjislacionit në fuqi në Shqipëri.

2- Me vendim të Asamblesë së Ortakeve mund të ndryshojë regjimin juridik të Shoqërisë, neqoftese në të ardhmen krijohen premisa më të favorshme për funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar.Në kete rast Asamblea e Ortkeve do të pershtase Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqërise,si dhe të beje regjistrimin e saj në regjistrin tregëtar të gjykatës së shkalles së parë Tiranë.

3- Shoqëria gëzon personalitetin juridik nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregëtar .

4- Shoqëria do të ketë vulën e saj.

Kreu II

TË DREJTAT DHE DETYRAT, KOHËZGJATJA

Neni 4 Të drejtat e Shoqërisë dhe të Asamblesë të Ortakëve.

- 1- Shoqëria ka të drejte të lidhe marrëveshje dhe të nënshkruaje kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.
- 2- Shoqëria gëzon të drejten të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.
- 3- Shoqëria ka të drejte të marrë pjesë si ortak në shoqëri ose ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 4- Shoqëria përgjigjet ndaj të treteve vetem dhe eskuzivisht me kapitalin e saj shoqëror të derdhur dhe me të mirat e pasurisë së saj.
- 5- Asambleja e Ortakëve merr pjesë në administrimin e veprimtarisë së Shoqërisë në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vetë ose nepermjet përfaqësuesve të saj.
- 6- Asambleja e Ortakëve ka të drejtë të marrë të gjitha informatat që kanë të bëjnë me veprimtarinë tregëtare të Shoqërisë, si bilancet, llogaritë ekonomike etj.
- 7- Asambleja e Ortakëve ka të drejte të bëjë propozime, si dhe të emerojnë e shkarkojnë administratorin punonjës, ekspertin kontabel apo likuidatorët.

Neni 5 Kohëzgjatja

- 1- Kohëzgjatja e Shoqërisë është mbi 10 vjet.

Kreu III

KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Neni 6

- 1- Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 000 Leke (njëqindmijë).
Ortkaku Mehmet Shaholli ka kuoten prej 90 000 leke ose 90 % të kapitalit themeltar.
Ortakja Elina Shaholli ka kuoten 10 000 leke ose 10 % të kapitalit themeltar.

Kreu IV

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 7

Vendimet në Shoqërisë meren nga Asambleja e Ortakëve. Keto vendime shënohen në Librin e Shoqërisë.

Kreu V

ADMINISTRIMI

Neni 8

- 1- Administrimi i Shoqërisë do të bëhet në përputhje me Statutin që i bashkëngjitet këtij Akti Themelimi të Shoqërisë.
- 2- Administratori i Shoqërisë do të jetë Mehmet Shaholli.

**Kreu VI
DISPOZITA TË TJERA**

1- Akti i realizuar nga Shoqëria, mbas shlyerjes së detyrimeve ligjore ndahen ndërmjet ortakëve në raport me përqindjet e tyre në kapitalin themeltar.
2- Ky Akt shtypet dhe firmoset në kater kopje, të gjitha me të njëjten vlerë ligjore. Një kopje qëndron në dokumentacionin baze të Shoqërisë.

ASAMBLEA E ORTAKËVE

ELINA SHAHOLLI

Elina Shaholli
Edu

MEHMET SHAHOLLI

Mehmet Shaholli
H

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA TIRANE

Nr. 304 Rep.


Nr. 64 Kol.


VERTETIM

Vertetohet se sot me datën 08.03.2002. në Tiranë, para meje noter Drita Pepi, e Dhomes së Noterisë Tiranë, me zyrë në rrugën "Zhan Dark", u paraqiten personalisht Ortakët e Shoqërisë "MELDI" SH.P.K. z. Mehmet Shaholli i biri Halimit dhe i Dudijes me dt. lindje 24.03.1963 lindur e banues në Cipan të rrethit Devoll me nr. pasaporte 1687869 dhe Elina Shaholli e bija e Xhevairit dhe e Skenderies me dt. lindje 12.10.1964 me banim në Cipan të rrethit Devoll me nr. pasaporte 1134151, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar të cilët deklaruan se sa më sipër është një Akt Themelimi i redaktuar jashtë kësaj zyre, me përmbajtjen e së cilit ishin dakord, të cilën e nënshkruan rregullisht dhe unë noteria e vertetoj sipas ligjës.

NOTERE

DRITA PEPI





STATUTI

I

SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TË KUFIZUAR

“MELDI” SH.P.K.

Themeluesit që firmosin si më poshtë:

1- Mehmet Shaholli i biri Halimit dhe i Dudijes me dt.lindje 24.03.1963.lindur e banues në Cipan të rrethit Devoll me numër pasaporte 1687869 dhe Elina Shaholli e bija e Xhevairit dhe e Skënderes me dt.lindje 12.10.1064 me banim në Cipan të rrethit Devoll me nr.pasaporte 113 4151.

Sot me daten,bazuar në vullnetin e tyre të lire dhe në perputhje me ligjin Nr.7638 date 19.11.1992”Per Shoqerite Tregtare”,kanë hartuar si më poshte vijon Statutin e Shoqerise Tregtare me Pergjegjesi të Kufizuar,të cilen e kane themeluar në bazë të Aktit të Themelimit.

Kreu I

OBJEKTI,EMERTIMI,SELIA,RREGJIMI JURIDIK

Neni 1. Objekti i Shoqerise është.

1- Tregëtim me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshem ushqimorë,bujqësore,farera,fidanë, pesticide,materiale ndertimi,makineri e pajisje dhe veprimtari të ushqimit social,bar-restorant.

Neni 2 Kohezgjatja

1. Kohezgjatja e Shoqerise eshte mbi 10 vjet.

Kreu III

KAPITALI THEMELTAR KUOTAT

Neni 3

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 leke.

Ortaku Mehmet Shaholli ka kuotën prej 90 000 lekë ose 90 % të kapitalit themeltar.

Ortakja Elina Shaholli ka kuoten prej 10 000 lekë ose 10 % të kapitalit themeltar.

Kapitali i shoqerise mund të shtohet ose të pakesohet sipas vendimeve që do të marrë Asamblea e Ortakëve të Shoqerisë.Ky kapital nuk mund të jete me i vogel se minimumi që lejon ligji.

Kreu IV

DREJTIMI DHE ORGANET KRYESORE

Neni 4

Shoqeria konsiderohet e krijuar në datën e rregjistrimit në Regjistrin Tregëtar në Gjykatën e Shkallës së parë Tirane dhe ushtron aktivitetin e saj pas regjistrimit si subjekt privat pranë organit tatimor.

2. Emertimi i Shoqerise tregëtare, kapitali themeltar i Ortakëve duhet të jenë të përmendura në të gjitha aktet dhe dokumentat që nxjerr kjo shoqëri dhe që ju drejtohen të treta.
3. Organet kryesore të Shoqerise janë: Asamblea e Ortakëve dhe Administratori.

Kreu V

ADMINISTRIMI

Neni 5

1. Administratori i shoqerise "Meldi" SH.P.K. është Mehmet Shaholli.
2. Administratori ka të gjitha të drejtat e fuqite për drejtimin e zakonshëm të Shoqerise, me qëllim që të arrijë objektivat e saj.
3. Administratorit i takon firma e lire dhe përfaqësimi i Shoqerise ndaj të treta në veprime, procedura dhe seanca gjyqësore ose administrative, si edhe pajtime e kompromise.
4. Administratori është përgjegjës sipas rasti ndaj shoqerise ose ndaj të treta për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo detyrës të kryera gjatë administrimit.
5. Kompetencat kryesore të administratorit në Shoqëri janë:
 - Të miratojë planet e llogarive ekonomike.
 - Të miratojë akte normative që përcaktojnë raportet në gjirin e Shoqerise, duke përfshirë kuadrin e personelit.
 - Të përfaqësojë Shoqërinë me të treta në të gjithë veprimtarinë e saj.
 - Të përcaktojë strukturën e aparatit të Shoqerise dhe të krijojë organe të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të Shoqerise.
 - Të për zgjedhë ekspertët kontabel dhe antarët e komisionit të likuidimit.
 - Të përcaktojë numurin e punonjësve të Shoqerise dhe pagat e tyre.

Kreu VI

VITI FINANCIAR, LLOGARITË VJETORE, NNDARJA E FITIMIT

Neni 6

1. Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.
2. Llogaritë vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e vecanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga Asamblea e Ortakëve të Shoqerisë.
3. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda 3 muajsh nga mbyllja e vitit financiar.

- 4 Të ardhurat neto të Shoqerise që rezultojne nga bilanci do të shperndahen si vijon:
5 % per fondin rezerve derisa ky fond të arrije 1/5 e kapitelit themeltar. Pjesa tjetër i takon ortakëve të shoqerise
- 5 Kontrolli i Shoqerise kryhet nga një ekspert kontabel i autorizuar, i emeruar per tre vite financiare, me mundesi rizgjidhjen e Asamblese të Ortakeve.
- 6 Shkarkimi i ekspertit kontabel vendoset ne të njejtat kondita si emerimi, në rast se verehen gabime ose behet e pamundur kryerja e detyres.

Kreu VII PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 7

- 1 Shoqeria mund të priset në cdo kohe dhe per cfardolloj shkak, si në rast falimentimi privim të të drejtave per të ushtruar aktivitetet tregëtar, forca madhore dhe faktore të tjerë që nuk varen nga ortakët e shoqerise.
- 2 Shoqeria hyn në momentin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Per kryerjen e ketij procesi Asamblea e Ortakëve emerojnë nje ose disa likuidues, të cilet i paraqesin atij raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe afatin e nevojshem të perfundimit të tyre.
- 3 Në fund të procesit të likuidimit Asamblea Ortakëve vendosi mbi bilancin perfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmerise së punes së likuiduesit dhe mbylljen e procesit të likuidimit.
- 4 Mbas pagimit të kreditoreve dhe shlyerjes së pjeseve të kapitalit themeltar tek kontrabuesit perkates, likuiduesi ndan kapitalet e mbetura per ortakët e shoqerisë.

Kreu VIII DISPOZITAT TË FUNDIT

Neni 8

- 1 Per atë cka nuk eshte parashikuar në kete Statut, do ti behet referimi i ligjit Nr. 7638 date 19.11.1998 "Per Shoqerite Tregëtare" si dhe ligjit 7667 dt. 28.01.1993. për regjistrin tregëtar.
- 2 Ky Statut hartohet në kater kopje, sejcila me vlere të njejte ligjore. Njera prej kopjeve ruhet në dokumentacionin baze të Shoqerisë.

ASMBLEA E ORTAKËVE

ELINA SHAHOLLI

MEHMET SHAHOLLI

Elina Shaholli
Eshy

Mehmet Shaholli
He